

MARRËVESHJA E PJESSHME PËR MOBILITETIN E TË RINJVE PËRMES KARTËS SË TË RINJTË



Paqes
kohezioni social
dialogut ndërkulturor
pjesëmarrjen
të drejtat e njeriut
qytetaria demokratike
hulumtime

Zhvillimin
e politikave
rinore

partial agreement on
**youth
mobility**
through the
EUROPEAN YOUTH CARD

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE



ÇFARË ËSHTË MARRËVESHJA Ë PJESHME:

Marrëveshja e pjeshme është një formë e veçantë bashkëpunimi në kuadër të Këshillit të Evropës. Ajo i lejon shtetet anëtare të bashkohen me një aktivitet të caktuar që avokohet nga shtetet e tjera anëtare, ose ta abstenojnë atë. Nga pikëpamja ligjore, marrëveshja e pjeshme mbetet një aktivitet i organizatës ashtu si edhe aktivitetet e tjera të programit. Ndryshimi qëndron tek fakti se marrëveshja e pjeshme ka buxhetin e vet dhe metodat e veta të punës, të cilat përcaktohen vetëm nga anëtarët e marrëveshjes së pjeshme.

MARRËVESHJA E PJESHME PËR MOBILITETIN E TË RINJVE PËRMES KARTËS SË TË RINJTË:

Kjo është një marrëveshje e pjeshme e hapur, dmth shtetet që nuk janë anëtare të Këshillit të Evropës, ose nuk janë palë në Konventën Kulturore Europiane, kanë të drejtë të bëhen pjesë e saj (shih më poshtë për më shumë).

Marrëveshja e Pjeshme është pjesë e Departamentit të Rinisë të Këshillit të Evropës dhe, duke qenë kështu, ndjek prioritetet dhe objektivat si të sektorit të rinisë dhe të Këshillit të Evropës në tërësi.

QËLLIMET:

1. Zhvillimi i skemës së Kartës së të Rinjve

Ajo u krijua në vitin 1991 dhe në Statutin e saj thuhet: «Marrëveshja e Pjesshme synon zhvillimin e skemës së Kartës së të Rinjve, veçanërisht në nivel evropian, në interesin më të mirë të të rinjve [...] me qëllim lehtësimin e mobilitetit të tyre, si dhe aksesin në mallra dhe shërbime të ndryshme të nevojshme për zhvillimin personal dhe kulturor të tyre». **Çdokush** nën moshën 30 vjeç mund të bëhet mbajtës i kartës së të rinjve – të riut nuk i nevojitet të jetë student ose rezident i një vendi evropian.

Kartat e të rinjve sigurojnë **aksesin e të rinjve**, qofshin rezidentë apo udhëtarë, për **këshillim, ulje dhe përfitime** në fushën e **mobilitetit, strehimit, kulturës, kurseve të gjuhëve, shërbimeve dhe produkteve** si *on-line* (sipas kategorisë, qytetit ose vendit) dhe *off-line*. Shumë vëmendje i është kushtuar zhvillimit të cilësisë dhe matjes së cilësisë së shërbimeve të ofruara për një ndikim pozitiv afatgjatë.

2. Zhvillimi i politikave më të mira për rininë me dhe për qeveritë anëtare

Qëllimi i dytë është **kujdesja për interesat dhe nevojat e qeverive anëtare** lidhur me **çështjet e mobilitetit të të rinjve dhe të kartës së të rinjve**. Programi i punës është hartuar në mënyrë të tillë që **të gjenerojë dhe të mobilizojë njohuri** mbi këto çështje, **të ndajë praktikat më të mira** dhe, në këtë mënyrë, të ofrojë zgjidhje më të mira për politikën (seminare, aktivitete, simpoziume, etj). Këto aktivitete janë ndjekur nga botime për praktikën më të mira dhe rekomandime për veprime specifike për shtetet anëtare dhe për organizatat kombëtare anëtare në EYCA.

Programi i punës është i hapur për pjesëmarrjen e shteteve jashtë Marrëveshjes së Pjesshme me shpenzimet e tyre. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të shteteve anëtare është e mbuluar plotësisht.

Për këtë qëllim janë aktivizuar një gamë e gjerë palësh të interesuara, si: qeveritë, institucionet evropiane,

komuniteti i biznesit, ekspertë, akademikë, OJQ-të për rininë, organizatat kombëtare për kartat e të rinjve, si dhe vetë mbajtësit e kartës së të rinjve. Kështu, shtetet anëtare edhe kontribuojë në mënyrë aktive edhe përfitojnë nga ekspertiza e Marrëveshjes së Pjesëshme.

SI REALIZOHET AJO:

Programi i aktiviteteve kontrollohet nga një **Bord Koordinimi** i përbërë nga 17 anëtarë:

- ▶ 8 përfaqësues të shteteve anëtare të Marrëveshjes së Pjesëshme të caktuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës;
- ▶ 8 anëtarë të Shoqatës së Kartës Rinore Evropiane (EYCA) të caktuara nga kjo e fundit;
- ▶ 1 përfaqësues i caktuar nga Këshilli Këshillimor për Rininë, pa të drejtë vote.

Programi i punës i Marrëveshjes së Pjesëshme zbatohet në bashkëpunim me **Shoqatën e Kartës Rinore Evropiane, EYCA**. Shoqata është strukturë jofitimprurëse e themeluar në vitin 1987. Ajo përfaqëson mbi 40 organizata kombëtare për kartën e të rinjve në të gjithë Evropën dhe ka mbi 5 milion karta në përdorim. Të gjithë anëtarët e EYCA-s janë angazhuar të promovojnë si individualisht dhe kolektivisht **mobilitetin e të rinjve, një stil të shëndetshëm jetese**, dhe qytetari aktive ndërmjet të rinjve.

PROCEDURA PËR T'U BËRË PJESË E MARRËVESHJES

Për shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet palë në Konventën Evropiane Kulturore:

Këto shtete anëtare mund të bëhen palë në Marrëveshjen e Pjesëshme në çdo moment thjesht duke i dërguar një deklaratë për këtë qëllim Sekretarit të Përgjithshëm. Deklarata përbëhet nga dërgimi i një letre zyrtare apo i një note verbale nga Ministri i Punëve të Jashtme, ose nga Përfaqësuesi i Përhershëm i vendit, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Për shtetet jashtë Këshillit të Evropës dhe që nuk janë palë në Konventën Kulturore Evropiane:

Me propozim të Shoqatës për Kartën Rinore Evropiane dhe Bordit të Koordinimit të Marrëveshjes së Pjeshme, Komiteti i Ministrave mund të ftojë çdo shtet joanëtar të Këshillit të Evropës që të bëhet palë në Marrëveshjen e Pjeshme, pas konsultimit të çdo shteti joanëtar që është palë në marrëveshje.

Këshilli i Evropës

Këshilli i Evropës është organizatë politike panevropiane e krijuar në vitin 1949 për të nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar, paqen, demokracinë dhe të drejtat e njeriut në të gjithë Evropën. Ai zhvillon përgjigje të përbashkëta për sfidat e ndërsjella në të gjitha sferat e jetës njerëzore, përveç fushave ekonomike dhe ushtarake. Këshilli i Evropës ka 47 shtete anëtare, dhe 50 shtete palë në Konventën Kulturore Evropiane dhe përfshin 820 milionë evropianë.

Spektori i Rinisë i Këshillit të Evropës

Këshilli i Evropës mbështet rolin aktiv të të rinjve në shoqëri përmes aktiviteteve të ndryshme evropiane, si me anë të bashkëpunimit ndërqeveritar, dhe trajnimit dhe aktiviteteve edukative për dhe me OJQ-të rinore dhe udhëheqësit e të rinjve. Qendrat Rinore Evropiane në Strasburg dhe Budapest, Fondacioni European i Rinisë dhe Marrëveshja e Pjeshme për Mobilitetin e Rinisë përmes Kartës për të Rinjtë janë instrumente thelbësore për të kryer këto aktivitete.

Kontakti në Sekretariat e Këshillit të Evropës

Directorate of Democratic Participation

Youth department (Agora Building)

Youth Policy Division

Partial Agreement on Youth Mobility through the Youth Card

F-67075 Strasbourg Cedex

Tel.:+33 (0)3 88 41 29 98

youthmobility@coe.int

<https://www.coe.int/en/web/youth/youth-mobility>

Premis 072121

SQI

www.coe.int

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

partial agreement on
**youth
mobility**
through the
EUROPEAN YOUTH CARD

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE